

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 24 MARS 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Seanca e sotme, në rastin më të mirë, është një seancë zhgënjyese, për të mos thënë një situatë parlamentare e vajtueshme. Në kushtet e një emergjence, një debati, i cili duhej të ishte nisur nga qeveria, duhej të ishte iniciuar nga vetë kreu i saj, po edhe në momentin që u iniciua nga opozita, qoftë në formën e mocionit, qoftë edhe të interpelancës, pati fenomenin e shkëlqimit me mungesën e tij, të Shkëlqesisë së Tij, Kryeministrit të Republikës.

Nga ana tjetër, anëtarët e kabinetit, pavarësisht se personalisht u njoh të drejtën e prezumimit të mungesës së përgjegjësisë, se nuk janë në ato poste për asnjëlloj merite politike, veç të qenit bashkëpunëtorë luajalë të kreut të tyre, ishin me të vërtetë për të ardhur keq. I ngjanin një grupi fëmijësh që luanin hareshëm në këndin e lojërave, në rastin e tyre me mikrofonin e podiumit të Kuvendit! Situata, zonja dhe zotërinj, është a-lar-mante! Nuk i lejohet ministres së Financave të këtij vendi t'i drejtohet nga podiumi i Kuvendit qytetarit që mendon kafshatën dhe gotën e qumështit, se është duke pritur raportin e inflacionit të muajit mars nga statistikat, në një kohë që monitoron në terren situatën e çmimeve, në mos nuk është 40, mund të jetë 35 apo 45. Ju mjaftoheni dhe na e thoni si arritje të politikës suaj tridhjetëmijë- lekëshin e vjetër për familjet në nevojë. A përlllogaritët qoftë edhe për një çast se sa litra qumësht i shtuat familjes në nevojë, apo bukë? Apo për ju janë të mjaftueshme 130 euro në muaj?

Zonja Ministre, në qoftë se nuk arrini dot të jetoni me dhimbjen e qytetarëve në këto momente, bëjuni një nder të fundit, ia lini dikujt tjetër atë post! Është një thirrje, në fakt, që nuk duhet t'ju drejtohet juve personalisht, por atyre që ju kanë zgjedhur ju aty dhe atyre që pretendojnë se janë drejtuesit e ekzekutivit të këtij vendi. Për të ardhur te projektligji, për të cilin kam kërkuar fjalën, në radhë të parë, a e ka parë Komisioni i Ligjeve atë dokument? A mundet një organ legjislativ të votojë një dokument, i cili nis me fjalën e drejtorit të një institucioni, i cili fillon: "Drejtuar kolegëve dhe përdoruesve"? Ky është ligj shteti? Dhe na thotë projektligji që do të votojmë, se "votohet konform tekstit shoqërues", një tekst, i cili, natyrisht, ka elemente të një programi, por ka edhe shumë elemente përshkruese. A e konceptoni një organ legjislativ, i cili voton përshkrime? Shikojeni! Tani, është fakt votimi i këtij dokumenti, por nga çdo këndvështrim është i papranueshëm nga mentaliteti legjislativ!

Një nga ndërmarrjet më të rëndësishme që ka përpara vendi është regjistrimi i ardhshëm i popullsisë dhe i banesave, Censi 2022. Një nga problemet thelbësore të praktikave të censit në vitin 2001 dhe 2011 ka qenë regjistrimi i pjesëtarëve të minoriteteve etnike dhe i komuniteteve fetare. Të dhënat e prodhuara kanë qenë të kontestuara si nga shoqatat përfaqësuese të minoriteteve, ashtu edhe nga komunitetet fetare. Këto shqetësime dhe kontestime kanë gjetur mbështetjen e tyre edhe në raportet

ndërkombëtare, kryesisht në ato të Këshillit të Europës, për respektimin e të drejtave dhe lirive të pjesëtarëve të minoriteteve kombëtare në vendin tonë. Duke pasur parasysh këtë situatë, cili do të ishte ndër prioritetet në vëmendjen e Institutit të Statistikave? Një komunikim i gjallë me përfaqësuesit qoftë të minoriteteve, ashtu edhe të komuniteteve fetare.

Po të shikoni përbërjen e Komisionit Qendror të Censit 2022, do të shikoni të gjithë ministrat, por nuk do të shikoni kryetarin e Komunitetit të Kulteve, nuk do të shikoni kryetarin e Komitetit të Minoriteteve. Përse? Në një kohë kur duhet të nisim një proces transparent që tani dhe në vazhdimësi, duke u konsultuar dita-ditës, përse kjo fobi? Sërish po minoni kredibilitetin e procesit, duke karakterizuar veprimet dhe praktikën e nevojshme deri në zhvillimin e procesit me një mentalitet, i cili shkon përballë transparencës dhe bashkëpunimit. Ju po e shteroni censin në këtë aspekt nga një instrument i domosdoshëm për politikën, në një instrument politik. Largohuni nga ky mentalitet! Kemi shumë sfida përpara dhe duhet që ato t'i kapërcejmë me sukses, me qëllim që t'i hapim dyert e integritetit të plotë në Bashkimin Europian. Si arrihet kjo? Duke ecur me mentalitete dhe praktika të tilla, që, në mënyrë të përsëritur, janë provuar të dështuara? Shikoni sot e kësaj dite. A kemi një pyetësor të qartë, përfundimtar? Jo, nuk e kemi. Ka ndryshime të shpeshta, të cilat krijojnë konfuzion, i cili do të reflektohet edhe në rezultatin e këtij censi. A duam realisht ne të kemi statistika, apo dëshirojmë të kemi manipulime? Është momenti të reflektojmë.

Nga ana tjetër, dëshiroj të konkludoj me një propozim, të cilin besoj se qeveria duhet ta shndërrojë në një nismë legjislative. Në të gjitha vendet, ku gjatë kohës së pandemisë janë kryer regjistrime të përgjithshme të popullsisë, duke filluar nga ato më të afërtat, fqinje dhe deri tek ato më të largëtat, u është dhënë qytetarëve mundësia e pjesëmarrjes dixhitale. Nuk ka mundësi që gjithë ditën të propagandojmë shtetin dixhital, shërbimet dixhitale, ndërkohë që në një proces të tillë madhor të mos u japim qytetarëve të drejtën të marrin pjesë në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave në mënyrë dixhitale. Është momenti të ndërmerret një nismë e tillë, të mos neglizhohet dhe të mos lihet për në momentin e fundit. Në një kohë që shteti propagandon se ofron shërbime të besueshme nga platforma e-albania, çfarë zgjidhje më optimale do të kishte për të gjitha shërbimet sesa dhënia e mundësisë që në Censin 2022 të mund ta plotësojnë formularin në mënyrë dixhitale? Faleminderit!